

Vendim nr. 227 datë 16.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 16.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 17 (P) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: PIRRO THOMO

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 2166, datë 14.02.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 327, datë 09.02.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-4247, datë 25.10.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në vitin 1960 shtetasi Th.Th. (babai i kërkuesit) ka blerë një shtëpi nga Komiteti Ekzekutiv i qytetit të Tiranës nëpërmjet një kontrate shitblerjeje (e regjistruar rregullisht në regjistrat hipotekarë të këtij viti), të cilën në vitin 1982 ia ka dhuruar bashkëshortes së tij. Pas vdekjes së kësaj shtetaseje kjo pasuri ka kaluar në pronësi të fëmijëve të saj, shtetasve V.Th., K.Th. dhe Pirro Thomos (*kërkuesi*). Me vendimin nr.82, datë 26.06.1995 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë (*KKKP, Tiranë*), trashëgimtarëve të ish-pronarit Sh.P. u është njohur dhe kthyer një pasuri e paluajtshme, e përbërë nga një sipërfaqe trualli dhe dy shtëpitë mbi të, vendim që është regjistruar edhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZVRPP*), Tiranë. Njëra prej dy shtëpive rezulton të jetë ajo e blerë nga babai i kërkuesit.

2. Nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. 1852 rep., dhe nr. 784 kol., datë 09.06.2006, trashëgimtarët ligjorë të Sh.P. i kanë shitur shtetasve S.T., S.T. dhe L.T. pasurinë e paluajtshme ku bën pjesë shtëpia e trashëguar nga kërkuesi. Kontrata e mësipërme rezulton se është regjistruar në ZVRPP-në, Tiranë me vërtetimin e pronësisë nr. 85, datë 27.06.2006.

3. Shtetasi S.T. rezulton t'i jetë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi për lirim dhe dorëzimin e truallit dhe objekteve mbi të ndaj dy vëllezërve të kërkuesit V.Th. dhe K.Th. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5136, datë 02.07.2007, ka vendosur rrëzimin e padisë. Gjykata e Apelit Tiranë mbi ankimin e S.T. ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe detyrimin e V.Th. dhe K.Th. t'i lironin dhe dorëzonin pasurinë objekt konflikti gjyqësor shtetasit S.T.

4. Shtetasi S.T. ka aplikuar për nxjerrjen e urdhrin të ekzekutimit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe më pas i është drejtuar Entit Kombëtar të Banesave Tiranë (*EKB*), duke kërkuar zbatimin e aktit normativ nr. 3, datë 01.03.2012 "Për lirim dhe banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë të subjekteve të shpronësuar...". Mbi bazën e njoftimkonfirmimit nr. 1064/1, datë 04.03.2013 të EKB-së, të cilësuar si titull ekzekutiv, me vendimin nr. 1657, datë 06.03.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përmbaruesi ka njoftuar kërkuesin dhe dy vëllezërit e tij V.Th. dhe K.Th. për ekzekutimin e këtij njoftimkonfirmimi. Për këtë veprim kërkuesi dhe dy vëllezërit e tij kanë liru banesën.

5. Duke marrë shkas nga sa më sipër, kërkuesi (i cili ndryshe nga vëllezërit e tij nuk ka qenë palë në gjykimin e parë), në datën 12.04.2013 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, duke kërkuar rivendosjen në vend të së drejtës së pronësisë, pushimin e cenimit të pronësisë e mospërsëritjen në të ardhmen, si dhe vendosjen e masës së sigurimit të padisë.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2166, datë 14.02.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë dhe të masës së sigurimit të padisë (vendosur me vendimin nr. 12160, datë 17.05.2013 të gjyqtarit të vetëm). Në vendimin e saj ajo gjykatë ka argumentuar se padia rezulton e pambështetur në ligj dhe kërkuesi edhe *de jure* nuk është pronar i pasurisë objekt gjykimi duke qenë posedues i paligjshëm i saj. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 327, datë 09.02.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke e vlerësuar të drejtë atë, ndërkohë që shkaqet e parashtruara në ankim nga kërkuesi janë konsideruar të pabazuara në ligj dhe në prova. Ndaj këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4247, datë 25.10.2023, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Ajo gjykatë arsyeton se nga ana e gjykatave të faktit janë respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit material dhe procedural. Gjithashtu, ajo gjykatë konstaton se pavarësisht një gabimi material dhe jo substancial në vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, që ka lënë në fuqi gabimisht një tjetër vendim dhe jo atë objekt ankimi, pretendimi i ngritur në rekurs nuk cenon vendimin e apelit në vetvete dhe se ky gabim mund të ndreqet sipas përcaktimeve të nenit 312 të *KPC*-së.

9. Në datën 14.06.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 25.07.2024. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, me vendimin nr.21, datë 01.10.2024, ka vendosur pranimin e kërkesës së një anëtari të saj për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje dhe po në atë datë ka vendosur caktimin e një gjyqtari tjetër në përbërje të Kolegjit për shqyrtimin paraprak të ankimit.

II

Pretendimet e kërkuesit

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar i është cenuar:

10.1. *E drejta për proces të rregullt në drejtim të:*

10.1.1. *Së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit dhe atij të sigurisë juridike*, pasi kërkuesi ka qenë pronar i ligjshëm i pronës nëpërmjet një kontrate blerjeje si një nga format e njohura nga ligji për fitimin e pronësisë. *KKKP*-ja, Tiranë i ka

kthyer ish-pronarit me të njëjtin vendim dy shtëpi, në kundërshtim me ligjin, pa marrë parasysh faktin se njëra banesë ishte shtetërore dhe tjetra, objekt gjykimi, ishte private. Gjithashtu, sipas tij, vendimi i KKKP-së, Tiranë nuk përbën titull ekzekutiv, por një akt administrativ.

10.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka bërë një interpretim arbitrar të ligjit material dhe procedural.

10.2. *E drejta e pronës private*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, nuk ka respektuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtën për proces të rregullt ligjor, duke cenuar rëndë të drejtën kushtetuese të pronës së kërkuarit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

11. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara në nenin 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vlerëson se kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

13. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, që pretendohet se janë cenuar. Në ankimin kushtetues individual kërkuari ka kundërshtuar

vendimin e Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor të nisur prej tij. Në këtë situatë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimit të kundërshtuar, për rrjedhojë përmbushet kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

14. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në lidhje me përlogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në çështjen konkrete, Kolegji evidenton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mban datën 25.10.2023, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 14.06.2024. Për qëllime të këtij shqyrtimi i është kërkuar informacion Gjykatës së Lartë, e cila në datën 02.08.2024 ka sqaruar se vendimi i kundërshtuar është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 17.11.2023, datë nga e cila është bërë i disponueshëm për palët. Gjithashtu, sipas akteve të vëna në dispozicion me ankimin kushtetues individual, nuk rezulton që kërkuesi të ketë lënë të dhënat e tij elektronike të kontaktit (*e-mail*).

16. Ndërkohë nga ana e kërkuesit, në ankimin kushtetues individual pretendohet se ai është njohur me vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Lartë në datën 19.02.2024, pas kërkesës nëpërmjet postës elektronike drejtuar asaj gjykate, e cila e ka njoftuar se vendimi i arsyetuar gjendej i botuar në faqen zyrtare të saj dhe se ai e ka depozituar ankimin kushtetues individual brenda afatit ligjor 4-mujor. Lidhur me këtë pretendim Kolegji çmon se data në të cilën kërkuesi ka marrë vendimin e Gjykatës së Lartë pas kërkesës së tij nuk është argument i mjaftueshëm kushtetues në lidhje me datën efektive të marrjes dijeni të tij, sepse një kërkesë e tillë për t’u njohur dhe për të tërhequr vendimin gjyqësor mund të bëhet në çdo moment nga palët ndërgjyqëse.

17. Në këndvështrim të sa më sipër, duke pasur parasysh standardet e vendosura nga Gjykata, si dhe duke qenë se kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë argument ose provë në lidhje me pamundësinë e tij reale për të ndjekur fatin e recursit të ushtruar nga ai, Kolegji vlerëson se si datë e marrjes dijeni të vendimit të Gjykatës së Lartë do të konsiderohet data kur ai është bërë i disponueshëm për palët, pra data 17.11.2023, ndërkohë që kërkesa është paraqitur në

Gjykatë në datën 14.06.2024, që do të thotë përtej afatit ligjor 4-mujor. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis* për kërkesën e tij.

18. Në kushtet kur kriteri paraprak për legjitimimin *ratione temporis* nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterit *ratione materiae* bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre. Prandaj, në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuetit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.